

Supreme Court of Kosovo
AP – KZ. No. 128/2010
3 August 2010

IN THE NAME OF THE PEOPLE

The Supreme Court of Kosovo in a panel composed of EULEX Judge Norbert Koster as Presiding Judge, with EULEX Judges Maria Giuliana Civinini, Gerrit-Marc Sprenger and Supreme Court Judges Marie Ademi and Nesrine Lushta as members of the panel, assisted by Jacqueline Ryan and Svetoslava Savova as recording clerks,

in the criminal case against the accused F **B** , father's name
mothers maiden name , born on 12 March 1969 in

, Kosovo married,
of three (3) children, literate, housewife, of average economic status and
without previous convictions, charged with the criminal act of murder contrary to
Article 146 of the Criminal Code of Kosovo (CCK), held in pre-trial detention from
24 May 2007 to 23 January 2008,

deciding upon the appeals filed by Defence Counsel Zeqir Berdyna (dated 23
February 2010) on behalf of the defendant and by Lawyer Haxhë Z. Nikçi (dated 18
February 2010) on behalf of the injured party A against the judgment P. No.
145/2009, rendered by the District Court of Pejë/Pec on 14 December 2009,

in a session, held on 3 August 2010, after a deliberation and voting renders this


JUDGMENT

The appeal of defense counsel Zeqir Berdyna is partially granted and the first instance
judgment modified as follows:

The accused is guilty of Murder committed in a State of Mental Distress in violation
of Article 148 of the CCK.

For this criminal offence a punishment of three (3) years six (6) months imprisonment
is imposed onto the accused.

For the criminal offence of Unauthorized Possession and Use of a Weapon
accused has already received a final sentence of eight (8) months imprisonment.



Hence, an aggregate punishment of four (4) years imprisonment for both criminal offences is imposed onto the accused.

The time the accused spent in pre-trial detention will be credited.

The condemnation of the accused to pay compensation to the injured party is annulled. The injured party has to pursue the compensation claim through civil litigation.

The appeal of the injured party is rejected as unfounded.

Reasoning:

I. Procedural History

On 24 May 2007, at about 08.20 hrs in _____, the victim M _____ was shot dead. The shooting took place in the house of V _____ who is the _____ of the defendant.

The criminal investigation against the defendant and _____ husband was initiated on 25 May 2007. The investigation against the _____ of the defendant was later terminated. With indictment, dated 02 August 2007, the District Public Prosecutor in Pejë/Peć charged the defendant with Murder in violation of Article 146 of the CCK and with the criminal offence of Unauthorized Ownership, Control, Possession or Use of Weapons pursuant to Article 328 paragraph 2 of the CCK.

The indictment was confirmed by the District Court of Pejë/Peć with Ruling, dated 18 September 2007.

The first main trial was conducted in closed sessions from 21 to 23 January 2008. The defendant was found guilty of the criminal offence of Unauthorized Ownership, Control, Possession or Use of Weapons and acquitted from the charge of murder. The defendant was sentenced to eight months of imprisonment. The judgment, dated 23 January 2008, was appealed by the public prosecutor and by the injured party.

The Supreme Court of Kosovo with decision, dated 05 February 2009 (Ap.-Kž No. 333/2008) confirmed the first instance judgment as far as the conviction was concerned. Concerning the acquittal the first instance judgment was quashed and the case sent back for retrial. The Supreme Court of Kosovo instructed the first instance Court to clearly and exhaustively state which facts it considers proven or not proven and the related grounds – especially in regard to the situation of necessary defence, which the first instance Court concluded the defendant had been acting



particular the Supreme Court ordered the knife found next to the victim's body to be examined for finger prints, the autopsy report of the victim's body should be examined and evaluated and if necessary, statements from experts on forensic medicine and ballistics should be obtained.

On 8 April 2009 the President of the Assembly of EULEX Judges based upon a request filed by the injured party issued a decision that the panel be composed of two (2) EULEX Judges and one (1) local Judge.

The retrial was held in closed sessions between 15 September and 14 December. With judgment, dated 14 December 2009, the District Court of Pejë/Peć found the accused guilty of murder contrary to Article 146 of the CCK and sentenced to ten (10) years of imprisonment. In addition the defendant was condemned to the payment of ten thousand (10 000) Euros to the injured party A B as partial compensation for the damage suffered.

The written verdict was served on the parties between 9 February and 6 March 2010.

On 22 February 2010 Defence Counsel Zeqir Berdyna on behalf of the accused filed an appeal against the judgment¹. On 19 February 2010 lawyer Haxhë Z. Nikci as representative of the injured party A B filed an appeal against the judgment.

II. Issues raised in the appeals:

Defence Counsel Zeqir Berdyna proposes to render a decision amending the judgment of the District Court of Pejë/Peć and to acquit the defendant "from the indictment".

He claims essential violation of the provisions of the criminal procedure code, violations of criminal law, wrong or partially wrong determination of facts. Furthermore he challenges the calculation of punishment.

In particular Defence Counsel Zeqir Berdyna contends:

- a. The enacting clause of the judgment lacks a description of facts, in particular with regard to the crime scene, the way and other circumstances of the commitment of the criminal offence. In addition also the motive and the intent of the defendant are not mentioned in the judgment.
- b. The facts were not properly determined. The defendant committed the crime in an act of necessary self-defence. The late victim had raped in 2003 and a second time later, after he got released from jail where

¹ According to the Court stamp the appeal was received on 22 February. Even the original of the appeal, however, shows the date 23 February 2010.



dhomës së pritjes së miqve. Në këtë moment ajo është dëshpëruar duke u habitur pse ky njeri ja kishte shkatërruar jetën. Ka shkuar në dhomën e tjetjes, ka marr pushkën e gjuetisë, e ka mbushur dhe ka shkuar në dhomën e pritjes së miqve. Ajo nuk ka dashur ta vras viktimën. Më saktë, ajo deshi ti bëj atij me dije që të mos dukej përsëri në shtëpi të saj pasi që tanimë ishte dhunuar dy herë nga ai. Ajo ka marrë armën për vet-mbrojtje sepse ajo e ka ditur se viktima gjithherë ka qenë i armatosur kur e ka dhunuar atë. Ajo ka hyrë në dhomën e pritjes së miqve dhe viktima që ishte duke qëndruar tek dritarja i ka thënë "Mos mendo se më frikëson me armë në duar oj bushtë". Në atë moment, ai ka hequr thikën prej xhepit dhe është përpjekur ti kap dorën me dorën tjetër. Ajo ka kërkuar nga ai tri herë që të dal prej dhomës por viktima nuk ka dalë. Në vend të kësaj, ai i është afruar. Kur ai ishte rreth dy metra tutje, ajo është ndjerë e përhumbur dhe ka drejtuar pushkën te dritarja me qëllim që të frikësoj viktimën dhe ta zmbrops. Pastaj ajo ka shtënë në dritare e cila ishte në të njëjtin drejtim sikur edhe pozita e viktimës. Asaj nuk i kujtohen dy gjuajtjet tjera. Po ashtu nuk i kujtohet si ka dal nga dhoma e pritjes së miqve dhe si ka ecur poshtë shkallëve. Pas një kohe të shkurtër, kanë arritur policia dhe ajo është arrestuar.


Dëshmitarët S T , R B , V B dhe A B janë të afërmit e viktimës së ndjerë dhe janë përpjekur që në deklaratat e tyre ta degradojnë të pandehurën gjoja ajo ka qenë e dashuruar në viktimën që nga viti 2003.

E pandehura ka qenë në shtëpi të saj e sulmuar nga viktima tri herë dhe ka vepruar në përpjekje për të mbrojtur jetën e saj dhe integritetin e saj etik dhe fizik.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar propozon të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të shqiptohet dënim më i ashpër për të pandehurën. Ai pretendon se e pandehura ka planifikuar vrasjen e viktimës prandaj dënimi me burgim prej dhjetë (10) vitesh nuk është në proporcion me natyrën e veprës penale të kryer. Duhet të merret parasysh se krimet e kryera nga gjakmarrje duhet të trajtohen si relikte të së kaluarës të cilat nuk kanë vend në shoqërinë moderne.

Zyra e Prokurorit Shtetëror të Kosovës (ZPSHK) me mendimin e datës 7 Maj 2010, propozon të refuzoj ankesën e të akuzuarës dhe të pranoj ankesën e palës së dëmtuar dhe shqiptoj dënim më të ashpër për të akuzuarën. ZPSHK mendon se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale. Në veçanti ZPSHK pohon se dispozitivi nuk përmban kundërshtime të brendshme ose mospërputhshmëri në mes të vet atij dhe arsyeve, si edhe është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi është dhënë për të gjitha faktet esenciale. Për më tepër, mbrojtja nuk ka specifikuar në ankesë shkeljet tjera të supozuara të dispozitave të procedurës penale.

Situatë faktike është vërtetuar drejt dhe tërësisht dhe konkluzioni i Gjykatës së shkallës së parë se e akuzuara ka kryer veprën penale Vrasje në pajtim me Nenet 171 dhe 172 të KPK është i saktë. Gjykata me të drejtë ka mohuar se krimi është kryer në pajtim me Nenet 171 dhe 172 të Nevojshme.



III. Konstatimet e Gjykatës Supreme

I.

Ankesa e bërë në emër të akuzuarës është paraqitur me kohë, është e pranueshme dhe pjesërisht e arsyetuar.

a.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk është tërësisht në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale.

Elementet e aktgjykimit janë përcaktuar sipas Nenit 396 Paragrafi 1 i KPPK sipas së cilës aktgjykimi duhet të ketë parathënie, dispozitivin dhe deklaratën e arsyetimeve. Përmbajtja e obligueshme e dispozitivit si *tenor sententiae* është specifikuar në Paragrafët 3 dhe 4 të Nenit 396 të KPPK. Paragrafi 4 i Nenit 396 të KPPK siguron se dispozitivi në rastin e dënimit duhet të përmbaj të dhënat e nevojshme të specifikuara në Nenin 391 të KPPK.

Neni 391 i KPPK në pjesën përkatëse përmban si vijon:

(1) Në një aktgjykim e cili e shpall fajtor të akuzuarin, gjykata duhet të shënoj me sa vijon:

1) Veprën penale për të cilën ai ose ajo është shpallur fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën e veprës penale së kryer, si edhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të kodit penal;

2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;

3)

Në këtë mënyrë, dispozitivi si pjesë esenciale e aktgjykimit duhet të përmbaj jo vetëm kualifikimet ligjore të veprës por po ashtu edhe një përshkrim preciz dhe të detajuar të gjithë fakteve dhe rrethanave të cilat janë bazat e zbatimit të dispozitave ligjore. Çdo lloj dykuptimësie apo kontradikte e bën këtë dispozitivë të pakuptueshëm².

² Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi datës 6 Prill 2010. Ap Kz. No. 368/2009



Në rastin në fjalë dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk reflekton tërësisht këto kërkesa ligjore. E akuzuara është shpallur fajtores:

“Për veprën penale Vrasje të M B , në pajtim me Nenin 146 të KPPK të kryer në me datën 24 Maj 2007”.

Është përmendur vetëm një numër i vogël i fakteve në këtë dispozitivë d.m.th emri i viktimës si edhe data dhe vendi i krimit. Kjo nuk është plotësisht e mjaftueshme. Përshkrimi faktik i kërkuar i veprës në fjalë e kryer nga e akuzuara, p.sh. mungon mënyra se si viktimja është privuar nga jeta. E njëjta vihet për paramendimin e saj që është parakusht i nevojshëm për vrasje megjithëse nuk është përmendur aspak në dispozitivë³.


Si rezultat diapozitivi lë të hapur mënyrën si është vrarë viktimja dhe në çfarë mënyrë saktësisht e akuzuara e ka ekzekutuar atë vrasje.

Sipas Nenit 403 Paragrafi 1 pika 12 e KPPK është shkelje absolute substanciale e dispozitave të procedurës penale nëse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm. Në pajtim me Nenin 424 Paragrafi 1 i KPPK kjo shkelje nuk lejon ndonjë opsion tjetër për Gjykatën e Apelit përveçse anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e lëndës për rigjykim. Përjashtimet e mundshme – shih Nenet 424 Paragrafi 2 dhe Paragrafi 1 i KPPK – nuk zbatohen pasi që ata i referohen shkeljeve të dispozitave të procedurës penale të drejtuar nga pikat 5, 8, 10 dhe 11 të Nenit 403 Paragrafi 1 të KPPK.

Mund të argumentohet se e vetmja zgjidhje e paraparë me ligj – anulimi i aktgjykimit dhe rigjykim i vetëm për arsye formale – është shumë e rreptë dhe nevojitet një interpretim korrektues i ligjit me qëllim të shmangies së rigjytimeve thjesht për arsye formale. Në rastin në fjalë, megjithatë një arsyetim preciz dhe i saktë nuk mund të gjendet në arsyetimin e aktgjykimit, po ashtu. Në të kundërtën, mungesa e përshkrimit faktik në diapozitiv konstaton përputhjen e saj edhe në arsyetimin e aktgjykimit i cili nuk është plotësisht në pajtim me dispozitat e ligjit. Neni 396 Paragrafi 7 i KPPK siguron se Gjykata në arsyetim duhet të shënoj:

“qartë dhe tërësisht cilat fakte i konsideron të dëshmuara dhe jo të dëshmuara”.

³ Për pjesën e lënë sa i përket paramendimit shih po ashtu Momcilo Grubac dhe Tihomir Vassiljevic, Komenti për (i aplikueshëm deri në Prill 2004) Ligjin mbi Procedurën Penale, botimi i dytë, 1998, Paragrafi 52 i Nenit 364 pika 11; shih po ashtu Gjykata Supreme e Kosovës FN 2



Një deklaratë e tillë e cila duhet të jetë precize, e saktë dhe të ketë përmbajtje gjithëpërfshirëse të fakteve përshkruese të ngjarjes, nuk mund të gjendet në aktgjykimin e shkallës së parë. Madje, bazës i mungon edhe përmbledhja e fakteve të cilat janë konstatuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm apo që janë marrë parasysh në bazë të parimit *in dubio pro reo*. Arsyet janë të paqarta posaçërisht kur kanë të bëjnë me motivin e të akuzuarës për të privuar viktimën nga jeta e tij. E akuzuara ka paraqitur një sqarim specifik si motiv për krimin; dhunën seksuale ndaj saj të kryer nga i akuzuari në të kaluarën. Nuk është e qartë nëse kolegji i shkallës së parë i ka konsideruar këto fakte si të vërtetuara ose jo. Nga njëra anë duket se përshkrimi i dhënë nga e akuzuara është pranuar⁴, kurse nga ana tjetër kolegji i shkallës së parë duket të mos ketë qenë i sigurt⁵. Përveç kësaj, gjatë llogaritjes së dënimit kolegji i shkallës së parë e ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese

*“praninë, në të kaluarën, të episodeve serioze të dhunës nga
M B kundër saj”⁶,*

sidoqoftë, duke mos vlerësuar nëse këto rrethana do të kishin rezultuar në një dënim për një krim më pak të rëndë si vrasja e kryer në gjendje të afektit mendor.


Prandaj, arsyet e aktgjykimit të shkallës së parë reflektojnë një përcaktim jo të plotë të fakteve. Pasi që, e akuzuara ka dhënë një sqarim të qartë, të detajuar dhe të bindshëm për krimin, gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar nga parimet *supozimi i pafajësisë* dhe *in dubio pro reo* si të drejtat më fundamentale të të pandehurës të përcaktuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të përcaktojë nëse faktet përkatëse duhet të vërtetohen apo duhet të hedhen poshtë në bazë të provave të cilat dëshmojnë se rrefimi i të akuzuarës është i pavërtetë. Këto parime, të cilat sigurojnë që të drejtat e të pandehurit të respektohen plotësisht gjatë gjyqimeve penale, kërkojnë që gjykata të jetë e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer krim. Çfarëdo dyshimi lidhur me këtë duhet të respektohet dhe të merret parasysh në dobi të pandehurit.

Në bazë të këtyre arsyeve në lëndën sikur kjo në fjalë, ku e akuzuara pohon vetëmbrojtjen e domosdoshme ose arsye tjera të cilat mund të zvogëlojnë përgjegjësinë e saj penale, nuk mund të përqendrohet vetëm në faktin se e akuzuara pa asnjë dyshim e ka privuar viktimën nga jeta. Kjo në vetvete nuk mjafton për të konstatuar fajësinë individuale personale të akuzuarës. Ligji ofron dispozita ligjore të shumta të cilat mundësojnë nivele të ndryshme të cilësimit të aktit të vrasjes së një personi tjetër. Këto nivele ndryshojnë nga vrasja e rëndë si alternative më serioze deri në madje duke mos qenë fare akt penal si alternativa më e favorshme, dhe rrjedhimisht ligji parasheh nivele të ndryshme të specifikuara në mënyrë eksplicite të fajësisë personale – vrasje e rëndë, vrasje, vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor – dhe madje edhe opsione të cilat përjashtojnë fajësinë e kryerësit dhe ndalojnë shqiptimin e dënimit – vetëmbrojtja e domosdoshme ose nevojë ekstreme. Parimi

⁴ Shih 3.4.3.2. të aktgjykimit të shkallës së parë

⁵ Shih 3.4.3.3. të aktgjykimit të shkallës së parë

⁶ Shih 4 “Dënim” të aktgjykimit të shkallës së parë.



supozimit të pafajësisë dhe in dubio pro reo kërkojnë që të konstatohet përtej dyshimit të arsyeshëm nivelin e saktë të fajësisë personale të pandehurit.

Prandaj, fusha e shqyrtimit nga Gjykata penale e cila i referohet vetëm aktit të vrasjes nuk do t'i plotësonte kushtet për një vërtetim korrekt dhe të plotë të fakteve si dhe nuk do të lejonte konstatimin e duhur të cilësimit juridik të aktit i cili është parakusht i domosdoshëm për përcaktimin korrekt të fajësisë personale dhe rrjedhimisht të dënimit të duhur të pandehurit.

Parimi i supozimit të pafajësisë kërkon që Gjykata të jetë e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm që alternativat të cilat do të rezultojnë në lirim të pandehurit mund të përjashtohen. Qartazi kjo nuk kërkon që Gjykata sipas detyrës zyrtare të marrë parasysh të gjitha alternativat teorikisht të mundshme. Në një situatë ku i pandehuri në mbrojtjen e tij apo saj jep një rrëfim lidhur me ngjarjen, Gjykata është e obliguar ta vlerësojë këtë rrëfim me kujdes të duhur dhe respekt të plotë të parimit të *supozimit të pafajësisë*. Si rezultat, Gjykata duhet të vlerësojë nëse përshkrimi i ngjarjes nga i pandehuri është i besueshëm dhe i arsyeshëm, nëse po, nëse ka dëshmi të cilat mundësojnë konstatimin përtej dyshimit të arsyeshëm se versioni i dorëzuar nga i pandehuri nuk është i vërtetë. Përndryshe, barra e provës do t'i kalonte të pandehurit i cili do të duhej të provonte pafajësinë e tij apo saj⁷.


Gjithashtu, në pajtim me parimin *in dubio pro reo* Gjykata është e obliguar të vlerësojë me kujdes nëse rrëfimi i dhënë nga e pandehura i mundëson aplikimin e dispozitës së ligjit penal i cili do të rezultonte në një dënim më pak të rëndë. Rrjedhimisht, Gjykata përsëri duhet të vlerësojë nëse përshkrimi i ngjarjes nga e pandehura është i besueshëm dhe arsyeshëm dhe, nëse po, nëse ka dëshmi të cilat mundësojnë konstatimin përtej dyshimit të arsyeshëm se versioni i dorëzuar nga e pandehura nuk është i vërtetë. Vetëm kjo qasje e garanton respektimin e plotë të parimit *in dubio pro reo*.

Për ta përmbledhur, kërkohet një vlerësim i përgjithshëm i fakteve të prezantuara, i cili juridikisht mund të jetë relevant, në mënyrë që të përcaktohet në mënyrë korrekte dhe precize fajësia e mundshme dhe dënimi i duhur për të pandehurën.

Në bazë të këtyre parimeve Gjykata e shkallës së parë është dashur që në lëndën në fjalë të përcaktojë nëse përshkrimi i fakteve lidhur me historinë dhe motivin e krimin, siç është dorëzuar nga e pandehura, është pranuar apo hedhur poshtë. Kjo mangësi rezulton në vërtetim jo të plotë të fakteve me pasojë që aktgjykimi i shkallës së parë do të duhej të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim sipas nenit 424 paragrafi 3 të KPPK-së.

Sidoqoftë, neni 424 paragrafi 4 i KPPK-së përcakton se Gjykata e apelit nuk do ta anulojë aktgjykimin e shkallës së parë kur e vetmja arsye për anulim është vërtetim i gabuar i gjendjes faktike të marrëdhënieve dhe ku e tëra që kërkohet për një vërtetim korrekt është një vlerësim i ndryshëm nga faktet tanimë të vërtetuara dhe jo mbledhja

⁷ Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimi i datës 11 dhjetor 2009. PKL-Kzz. Nr. 23/2009; i njëjti në vendet tjera Evropiane – për Mbretërinë e Bashkuar, për shembull http://www.cps.gov.uk/legals/to_a_self_defence/; për ndalimin në përgjithësi të kalimit të barrës në provës tek të akuzuari shih aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në *judicial* kundër *Austriës dhe Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*.



e dëshmime të reja ose përsëritja e dëshmime të paraqitura. Në këso raste, Gjykata e apelit do të veproj në pajtim me nenin 426 të KPPK-së, p.sh. ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se dëshmitë e paraqitura në shkallën e parë janë plotësisht të mjaftueshme për të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe korrekte gjendjen e marrëdhënieve. Prandaj, Gjykata Supreme pavarësisht nga shkeljet e ligjit të procedurës dhe në bazë të nenit 424 paragrafit 4 të KPPK-së si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përmbahet nga prishja e aktgjykimit të shkallës së parë dhe dërgimit të lëndës në një rigjykim tjetër, duke vepruar në këtë mënyrë i kushton rëndësi të posaçme faktit që lënda tanimë është gjykuar dy (2) herë në shkallën e parë.

b.

Lidhur me ndryshimet e aktgjykimit të shkallës së parë, Gjykata Supreme konstaton si në vijim:

Siç është cekur më lartë, rrëfimi i të akuzuarës lidhur me ngjarjet të cilat kanë ndodhur para vrasjes së viktimës së ndjerë, është i detajuar dhe absolutisht i besueshëm. Prandaj, ky rrëfim në hap të parë duhet të pranohet nga Gjykata, edhe pse e akuzuara nuk është në gjendje të ofrojë prova lidhur me aktet e dhunës seksuale të kryera kundër saj nga viktimja e ndjerë. Përndryshe, barra e provës do t'i kalonte të akuzuarës.


Në hapin e dytë, duhet të vlerësohet nëse ka dëshmi të cilat lejojnë hedhjen poshtë të rrëfimit të të akuzuarës përtej dyshimit të arsyeshëm si të pavërtetë. Sidoqoftë dëshmi të tilla nuk mund të gjenden në lëndën në fjalë. Deklaratat e dëshmitarëve lidhur me pretendimin e lidhjes së dashurisë në mes të të akuzuarës dhe viktimës së ndjerë nuk janë të besueshme. Lidhur me këtë, kolegji i Gjykatës Supreme i referohet vlerësimit përkatës në aktgjykimin e shkallës së parë⁸ në mënyrë që t'i shmanget përsëritjes.

Si rezultat përshkrimi i fakteve të paraqitura nga i akuzuari – dy (2) raste të dhunës seksuale të kryera nga i akuzuari kundër saj dhe kërcënime tjera – duhet të pranohet në përputhje me parimin *in dubio pro reo*.

Ky ndryshim i gjendjes faktike po ashtu kërkon edhe adaptimin e cilësimit juridik.

Në lidhje me këtë kolegji i Gjykatës Supreme është, fillimisht, në pajtim me Gjykatën e shkallës së parë se e akuzuara nuk mund të pretendojë me sukses në vetëmbrojtje të domosdoshme. Madje edhe duke marrë parasysh se viktimja ndoshta ishte hyrë në pronën e të akuzuarit pa leje, nuk duhet të injorohet se e akuzuara morri pushkën e gjuetisë nga dhoma a fjetjes, e mbushi atë e pastaj shkoi te viktimja edhe pse bashkëshorti i saj dhe vjehrra e saj ishin të pranishëm aty afër. Në këtë situatë mund të vërtetohet një sulm i pashmangshëm i viktimës kundër të akuzuarës.

⁸ Shuli 3.4.2. të aktgjykimit të shkallës së parë




Vepra e të akuzuarës, megjithatë, qartë shfaq elementet e vrasjes të kryer në gjendje të afektit mendor në përputhje me nenin 148 të KPK-së.

E akuzuara, pa fajin e saj, ishte në gjendje të shokut të rëndë të shkaktuar nga veprimet e dhunës seksuale të shkaktuara nga ana e viktimës kundër saj dhe deklarimet e tij se do të përsëriste ato veprime. Viktima e kishte detyruar atë dy (2) herë për marrëdhënie seksuale kundër vullnetit të saj. Përveç kësaj ai kishte fotografuar trupin e saj të zhveshur të cilën ai e mbante në foto-aparatin e tij, duke e kërcënuar atë se do ta publikonte këtë fotografi në internet në rast se ajo do ta lajmëronte atë. Gjithashtu, viktima e kishte kërcënuar atë se do t'ia bënte të njëjtën gjë edhe vajzës së saj. Edhe pse rasti i parë i marrëdhënies seksuale me forcë kishte ndodhur vite më parë, ka një lidhshmëri në mes këtyre ngjarjeve. Menjëherë pas rastit të parë viktima duhej të kryente një dënim me burgim të shqiptuar ndaj tij për një krim tjetër (grabitje), një fakt që e bëri viktimën të shpresojë se dhuna kundër saj kishte marrë fund. Pas lirimit të tij nga burgu, megjithatë, dhe vetëm disa javë para se e akuzuara ta privonte nga jeta viktimën, ndodhi rasti i dytë i marrëdhënies seksuale me forcë, duke mos i lënë hapësirë të akuzuarës të besonte se viktima do të ndalte sjelljen e tij të dhunës. Edhe më keq, pak kohë para këtij rasti të dytë të dhunës kishte vdekur nëna e viktimës, të cilës e akuzuara i kishte kërkuar ndihmë pas rastit të parë. Për shkak të vdekjes së saj e akuzuara më nuk kishte asnjë person kujt do të guxonte ti lajmëronte për dhunën në vazhdim. Prandaj ajo ndjehej e pashpresë sa i përket dhunës së mëtejshme të viktimës i cili nuk u ndal së deklaruar vepra të mëtejshme të dhunës kundër saj.

Në ditën kritike të gjitha këto u grumbulluan në një gjendje të afektit mendor në fund kur viktima nuk iu bind urdhrat të saj që ai të dilte nga shtëpia e saj. Viktima prapë morri lirinë të hynte në pronën e të akuzuarës, ai madje hyri në shtëpi dhe prapë e kërcënoi atë, qartazi duke treguar se do ta injoronte vullnetin e saj.

Është pa asnjë dyshim e besueshme se e akuzuara përmes kësaj sjelljeje duke marrë parasysh veprat e mëparshme të dhunës seksuale kundër saj ajo arrit deri te gjendja e afektit mendor, dhe vërtetë shfaq shenja të qarta të kësaj gjendje mendore të veçantë gjatë dhe pas kryerjes së krimit.

Dëshmitari V **B**, bashkëshorti i të akuzuarës në shqyrtim gjyqësor më 22 shtator 2009 deklaroi se ai hyri në dhomë ku kishte ndodhë gjuajtja pas të shtënës së dytë dhe pa gruan e tij duke shkrepur të shtënë e tretë. Ai i bërtiti asaj dhe u përpoq ta kapte atë dhe ta largonte. Ajo, megjithatë, nuk reagoi. Ai nuk e kishte madje të qartë nëse ajo e kishte dëgjuar atë pasi që ajo as që kishte shikuar në drejtim të tij. Ajo vetëm u sill duke mos thënë asgjë dhe, pasi që arma e përcillte lëvizjen e saj, ajo disi e drejtoi armën në drejtim të tij. Ai u frikua se mund ta qëllonte atë dhe doli nga dhoma. Kjo dëshmi qartë pasqyron shenja të afektit mendor të akuzuarës së cilës burri i saj as që mund ti afrohej. Po ashtu sjellja e të akuzuarës menjëherë pas kryerjes së krimit tregon shenja të afektit mendor. Ajo doli nga shtëpia dhe u ul jashtë në shkallë, duke e mbajtur ende pushkën dhe e pa interesuar në asgjë çka ishte duke ndodhur përreth, disi mendërisht e hutuar dhe duke mos u përgjigjur as pyetjeve të burrit të saj. Kjo korrespondon me mungesën e pjesshme të kujtesës siç e kishte përmendur vetë e akuzuara. E akuzuara deklaroi se i kujtohet vetëm e shtëna e parë dhe nuk i kujtohet asgjë për dy të shtënat pasuese dhe ngjarjet pas kësaj. Është e rëndësishme të akuzuara nuk e përdori këtë mungesë të kujtesës si arsyetim sepse ajo e pranonte



shtënë e parë – vdekjeprurëse – dhe asnjëherë nuk e mohoi të ketë privuar viktimën nga jeta e tij. Në veçanti marrë parasysh dëshminë e burrit të saj deklarata e saj sa i përket mungesës së kujtesës mund të shihet si e besueshme. Një mungesë e pjesshme e kujtesës e tillë gjatë kryerjes së një krimi që është pranuar të jetë kryer, është shenjë tipike e afektit mendor.

Si rezultat kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ka dyshim se e akuzuara veproi në gjendje të afektit mendor. Si pasojë e kësaj, Gjykata Supreme e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë në përputhje me nenin 424 Paragrafi 4 dhe nenin 426 të KPPK-së dhe shpalli të akuzuarën fajtoreshë për vrasje të kryer në gjendje të afektit mendor në përputhje me nenin 148 të KPK-së.

Për të përcaktuar dënimin e përshtatshëm brenda një (1) deri në dhjetë (10) vjet burgim, të paraparë me nenin 148 të KPK-së, Gjykata Supreme morri parasysh të gjitha rrethanat rënduese si dhe lehtësuese.

Gjykata Supreme në veçanti e konsideroi si rrethanë lehtësuese gjendjen familjare të së akuzuarës dhe faktin se ajo nuk ka dosje kriminale. Përveç kësaj nuk mund të injorohet se ajo dhe familja e saj tani janë të nënshtruar ndaj kërcënimeve dhe frikësimeve nga ana e familjes së viktimës së ndjerë.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse Gjykata Supreme e Kosovës për veprën penale të vrasjes të kryer në gjendje të afektit mendor shqiptoi të akuzuarës një dënim me

tri (3) vjet e gjashtë (6) muaj burgim

Pasi që e akuzuara është shpallur fajtoreshë edhe për veprën penale të posedimit të paligjshëm të armëve dhe është dënuar me tetë (8) muaj burgim për këtë veprën penale, në përputhje me nenin 71 të KPK-së duhet të caktohet një dënim unik.

Sipas nenit 71 Paragrafit 2 të KPK-së dënimin unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim individual po nuk mund të jetë aq i lartë sa shuma e të gjitha dënimeve të përshkuara.

Brenda kësaj hapësire Gjykata Supreme e Kosovës prapë morri parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe shqiptoi të akuzuarës një dënim me

katër (4) vjet burgim

Sa i përket dënimin të së akuzuarës për të paguar dhjetë mijë (10 000) euro si kompensim të pjesshëm palës së dëmtuar kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se dënimin i tillë në përgjithësi nuk mund të kundërshtohet. Në këtë lëndë, me dënimin nuk është e mundur të gjendet asnjë fakt që do të mund të lejonte madje një ofruesim



të përfaqësuar të dëmtuar të palës së dëmtuar. Prandaj dënimi i të akuzuarës për të paguar kompensim të pjesshëm anulohet.

2.

Duke u bazuar në arsyet e shënuara më lart ankesa e palës së dëmtuar është e pabazuar.

GJYKATA SUPREME E KOSOOVËS NË PRISHTINË
AP – Kž. Nr. 128/2010

Kryetari i Kolegjit

Norbert Koster

Anëtare e Kolegjit

Maria Giuliana Civinini

Anëtare e Kolegjit


Marie Ademi

Anëtar i Kolegjit

Errit-Marc Sprenger

Anëtare e Kolegjit

Nesrine Lushta



Gjykata Supreme e Kosovës
AP – KZ. Nr. 128/2010

**Mendimi mospajtues i Gjyqtares Maria Giuliana Civinini
në lëndën kundër F B të akuzuar për vepër penale të vrasjes në kundërshtim të
nenit 146 të Kodit Penal të Kosovës (CCK)**

Në seancën e mbajtur më 3 gusht 2010 Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi aktgjykimin që pjesërisht pranon ankesën avokatit mbrojtës Zeqir Berdyna. Aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar dhe e akuzuara është shpallur fajtores për Vrasje të kryer në Gjendje të Afektit Mendor në shkelje të nenit 148 të KPK-së.


Gjyqtarja e Gjykatës Supreme e nënshkruar më poshtë, MG. Civinini, anëtare e kolegjit në këtë lëndë dhe e pranishme në të gjitha fazat e kësaj procedure në Gjykatën Supreme, nuk pajtohet me vendimin e përmendur të Gjykatës Supreme në veçanti kur Gjykata Supreme vendosi se krimi i kryer nga F B duhet të cilësohet si "Vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor" (neni 148 KPK).

Prandaj, adresohet mendimi mospajtues në vijim, i bazuar në rrethanat ligjore dhe faktike të gjyqtares së nënshkruar më poshtë:

1. Akuza për vrasje në shkelje të nenit 147 të KPK-së e ngritur kundër të pandehurës (sipas aktakuzës së paraqitur më 2 gusht 2007 dhe të vërtetuar më 18 shtator 2007) duhet të merret si e vërtetuar: më datën 24 të vitit 2007 F B e kishte parë M B, kushëririn dhe fqinjin e burrit të saj, se kishte hyrë në shtëpinë e saj (përmes një dritareje) dhe se kishte shkuar në drejtim të katit të epërm dhe të dhomës së mysafirëve (të ashtuquajturën "odën e burrave"); ajo shkoi në dhomën e saj, morri pushkën e gjuetisë të burrit të saj, e mbushi atë dhe i futi disa fishekë në gjepin e saj; pastaj ajo shkoi në katin e epërm dhe nga dera e dhomës së mysafirëve e pa M B duke shikuar jashtë dritares; gjersa ai ishte duke u kthyer kah ajo, ajo shtiu dhe e qëlloi viktimën në bark; ai u rrëzua në bark; ajo e rimbushi pushkën dhe e qëlloi dy herë në shpinë në një sekuencë kohore shumë të shkurtë.

Këto fakte ishin vërtetuar shumë drejt nga ana e Gjykatës së shkallës së parë të konfirmuara edhe me vendimin mbi ankesën.

Deklarata e të pandehurës (se ishte e dhunuar nga viktimja dy apo tri herë në mes të




krimin) nuk mbështetet nga informata të besueshme e as nga dëshmitë.

2. Sjellja kriminale e të akuzuarës nuk mund të cilësohet si Vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor nga neni 148 CCK.

3. Neni 148 i KPK-së nuk është një krim autonom por një rrethanë lehtësuese e veçantë e krimin të vrasjes. Në këtë kuptim duhet të merren parasysh këto rrethana: 1) Neni 148 i KPK-së nuk përmban përshkrim autonom të sjelljes kriminale as të elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale (*dolus*, dashja); 2) "*Interesi i mbrojtur me ligj*" është i njëjtë për vrasje dhe për Nenin 148 të KPK-së (jeta e njeriut); 3) Vepra penale e vrasjes dhe sjellja e përshkruar me nenin 148 të KPK-së plotësisht e mbulojnë njëra tjetrën; 4) Neni 148 i KPK-së përfshin elemente që nuk kërkojnë të përfundohet se krimi i vrasjes është kryer me të vërtetë; 5) Shkaktari i *stresit /shokut* i përshkruar më tutje në nenin 148 është element i jashtëm në kryerjen e vrasjes, një ngjarje e mëparshme e saj që nuk arsyeton (sikur në rast të vetëmbrojtjes) vetë kryerjen por përfshin një zvogëlim të dënimit.

4) Ky vlerësim ka pasoja lidhur me barrën e provës: prokurori publik ka barrën e sigurimit të dëshmive të plota të elementeve objektive (sjelljen), elementeve subjektive (fajësinë), mungesën e arsytimit (çdo arsye e drejtë për kryerjen e një vepre që në të kundërtën do të ishte krim) dhe rrethanave rënduese por prokurori publik nuk ka barrën e provës së rrethanave lehtësuese; në këtë kuptim, rrethanat lehtësuese nënkuptojnë një dënim të veçantë në dobi të të pandehurës dhe prandaj i takon të pandehurës që ta dëshmojë atë (ose të paktën të paraqesë fakte të hollësishme dhe të besueshme që mundësojnë hetime kuptimplota me pasoja të pafavorshme nëse kjo palë nuk arrin të paraqesë këto fakte).

5) T'i lihet barra e provës e rrethanave lehtësuese palës e cila propozon se nuk është në kundërshtim të nenit 6 të KEDNj-së dhe parimit të supozimit të pafajësisë me konkluzionin e parimit *in dubio pro reo*. Në fakt, nuk janë dëshmitë e krimin por dëshmitë e elementeve faktike të cilat kanë efekt në dënimin. Kjo është konfirmuar me disiplinën e ashtuquajtur "alibi" (*id est*: Kur një person i ngarkuar me një krim, dëshmon (*se vadem die fuisse alibi*) se ai ka qenë, në kohën e pretenduar, në një vend tjetër nga ai në të cilin është kryer krimi, ai thuhet



dëshmuar alibinë, efekti i të cilit është të vendoset themeli i konkluzionit të domosdoshëm, se ai nuk ka mundur ta kryente atë”), neni 308 i KPPK-së (“Jo më vonë se tetë ditë pasi që mbrojtësi nga prokurori i merr materialet e parapara sipas nenit 307 të këtij Kodi dhe jo më vonë se në seancën e konfirmimit, ose kur nuk ka seancë të tillë, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mbrojtja sipas rrethanave: 1) Njofton prokurorin për qëllimin e prezantimit të alibitë, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe emrat e dëshmitarëve me çdo provë tjetër që e mbështet alibinë; 2) Njofton prokurorin për qëllimin e prezantimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë që e mbështet arsyen e tillë dhe 3) Prokurorit i siguron emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t’i thërret për dëshmim.”)

6) Dhe, në këtë rast, e pandehura nuk ka ofruar as dëshminë më të vogël për rrethanat lehtësuese të *stresit/shokut* të përcaktuar me nenin 148 të KPK-së. Deklarata/pohimi i vetëm i të pandehurës nuk mund të merret në konsideratë; është vetëm një deklaratë dhe duhet të mbështetet nga dëshmitë e duhura. Nëse ne vërtetojmë se në këtë lloj të lëndëve (kur kemi vetëm një deklaratë të thjeshtë, pa dëshmi) ne duhet të zbatojmë parimin in *dubio pro reo*, dhe ne e vendosim barrën e provës negative (mungesa e dëshmive lehtësuese) te prokurori publik. Pasoja e zbatimit të përgjithshëm të këtij arsyetimi do të ishte brengë serioze: vrasja mund t’i shmanget dënimit të duhur me anë të një pohim të thjeshtë të të pandehurit.

Përveç kësaj, lidhur me deklaratën e të pandehurës (e cila nuk është e mjaftueshme për të arsyetuar zbatimin e nenit 148 të KPK-së), duhet vërejtur se jo vetëm se nuk ka dëshmi të dhunimit (dy episode kinse të kryera nga viktima pas luftës dhe disa kohë para vrasjes) por edhe një numër i dëshmitarëve të besueshëm kanë vërtetuar se ka ekzistuar një aferë dashurie në mes të këtyre dyve (fakti që dëshmitarët janë të afërm ose miq të viktimës dhe nën stresin e humbjes së një anëtarit të ri të familjes nuk mjafton që dëshmitarët të konsiderohen si jo të besueshëm).

Në këtë kuptim, fakti relevant që është provuar: kur viktima është sulmuar dhe vrarë, ai ka qenë në vendin e të pandehurit pa këpucë dhe duke shikuar nga dritarja në një mënyrë shumë të relaksuar. Ky fakt tregon në mënyrë të qartë se ambienti nën stres të frikës/kërcënimit i përshkruar nga e pandehura për të arsyetuar zbatimin e nenit 148, asnjëherë nuk ka ekzistuar.


7) Në cilindo rast, madje edhe në rastet e episodeve të dhunimit në të kaluarën, nuk ka pasur reagim të menjëhershëm (çfarëdo çoftë) pas dhunimit; në të kundërtën *stresi/shoku* shfaqet pas



një kohe të gjatë pas ngjarjes të cilat nuk i kanë karakteristikat e maltretimeve sistematike dhe të rregullta. Kjo krijon një situatë delikate sepse duke supozuar se një deklaratë e vetme e të pandehurës duhet konsideruar si dëshmi e mjaftueshme dhe arsytim për zbatimin e nenit 148 të KPK-së, me paragjykim paraqitet në sistemin penal "*honor cause*" (-hakmarrje) si rrethanë lehtësuese e vrasjes së një dhunuesi (ose, madje edhe më keq, në rastet e vrasjes së dashnorit të një gruaje të martuar). Në këtë kuptim, shtetet Evropiane të cilat e kanë pasur këtë "*honor cause*" si rrethanë lehtësuese në legjislacionin e tyre penal e kanë shfuqizuar atë para shumë kohe për mos ta lidhur atë me "etikën/nderin" dhe konsideratën për jetën e njeriut. Duhet marrë parasysh se gjithashtu neni 147 n. 9 i KPK-së e konsideron hakmarrjen dhe motivet tjera bazike (të liga) si rrethanë rënduese. Nëse në mes të kryerjes së vrasjes dhe njëres prej viktimave nuk ka lidhje në mes të veprimeve/reagimeve (që gjithashtu ekzistojnë në rast të maltretimeve të rregullta dhe të vazhdueshme), krimi më parë bie nën nenin 147 n. 9 sesa nën nenin 148 të KPK-së.

Prishtinë, 13/09/2010

Maria Giuliana CIVININ



Gjykata Supreme e Kosovës
AP – KZ. Nr. 128/2010

**Mendim mospajtuës i Gjyqtarës Maria Giuliana Civinini
në lëndën kundër F B , e akuzuar për veprën penale të Vrasjes në kundërshtim
me Nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me pikën e ligjshmërisë së
dispozitivit**

Në seancën e mbajtur më 3 gusht 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori aktgjykimin me të cilin pranoi pjesërisht ankesën e avokatit mbrojtës Zeqir Berdyna.


Në pikën e ngritur nga avokati mbrojtës lidhur me pavlefshmërinë e dispozitivit (varësisht nga mungesa e përshkrimit të fakteve, në veçanti lidhur me vendin e ngjarjes, mënyrën dhe rrethanat e tjera të kryerjes së veprës penale), në arsyetim vërtetohet si më poshtë:

"Vetëm një numër i vogël faktesh përmenden në këtë dispozitiv, dhe atë emri i viktimës si dhe data dhe vendi i krimit. Kjo gjë nuk është e mjaftueshme. Përshkrimi i nevojshëm faktik i kësaj vepre konkrete të kryer nga e akuzuara, d.m.th. mungon mënyra në të cilën ajo kishte privuar nga jeta viktimën. E njëjta gjë vlen edhe për paramendimin e saj që është parakusht i nevojshëm për vrasje, edhe pse kjo nuk përmendet fare në dispozitivin e aktgjykimit.

Si pasojë e kësaj, dispozitivi lë të hapur mundësinë e mënyrës në të cilën viktimja ishte vrarë d.m.th. saktësisht mënyrën në të cilën e akuzuara kishte ekzekutuar vrasjen. Në pajtim me Nenin 403, paragrafin 1, pikën 12 të KPPK-së në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit ka qenë i pakuptueshëm, një gjë e tillë paraqet shkelje absolute përmbajtjesore të dispozitave të procedurës penale. Në pajtim me Nenin 424, par. 1 të KPPK-së kjo shkelje nuk mundëson asnjë opsion tjetër për Gjykatën e Apelit përveç anulimit të aktgjykimit dhe kthimit të lëndës për rigjykim. (...) Mund të argumentohet se zgjidhja e vetme e paraparë me ligj – anulimi i aktgjykimit dhe rigjykimi vetëm për arsye formale – është tepër e rreptë dhe kërkon një interpretim të korrigjuar të ligjit me qëllim të shmangies së rigjykimeve vetëm për shkak të arsyeve formale. Lidhur me çështjen në fjalë, megjithatë, nuk ka as deklaram të saktë dhe të përpiktë të fakteve në arsyetimin e aktgjykimit. (...) Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se dëshmitë e paraqitura në shkallën e parë janë plotësisht të mjaftueshme për ta konstatuar në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen faktike. Prandaj, Gjykata Supreme, pavarësisht shkeljeve të ligjit të procedurës dhe në bazë të Nenit 424, par. 4 të KPPK-së si dhe Nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përmbahet nga prishja e aktgjykimit të shkallës së parë dhe kthimit të lëndës në rigjykim, duke i dhënë rëndësi të veçantë faktit se lënda tashmë është gjykuar dy (2) herë në shkallën e parë."

Unë fatkeqësisht nuk mund të pajtohem me konstatimin se dispozitivi është i pavlefshëm për shkak se:

1. Arsyetimi nuk përputhet me dispozitivin i cili nuk përmban deklaramin e pavlefshmërisë së dispozitivit të shkallës së parë. Një gjë e tillë nuk është në pajtim as me rregullat e procedurës (nenet 120 dhe 121 të KPPK-së).
2. Duhet që të sqarohen kushtet e përgjithshme ligjore të dispozitivit si një pjesë e aktgjykimit (shih po ashtu edhe lëndën e L. Xh. në Gjykatën Supreme, të datës 12 prill 2010).



a) Aktgjykimi i shkallës së parë duhet të përfshijë: hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin (neni 396 par. 1 i KPPK-së); Dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshijë të dhënat personale dhe vendimin (mbi fajësimin apo lirimin) dhe në rast të dënimit; aktin për të cilin i pandehuri është shpallur fajtor me indikacione në veprën penale, faktet dhe rrethanat esenciale dhe dënimin (neni 396 par. 3 dhe 4 lidhur me nenin 391 të KPPK-së); arsyetimi duhet të përfshijë bazën faktike dhe ligjore të vendimit, vlerësimin të dëshmive dhe të rrethanave të cilat konsiderohen përkatëse për dënimin (neni 396 par. 6 deri në 10 i KPPK-së).

b) Aktgjykimi konsiderohet si unik me nenet 402 dhe 403.

c) Në bazë të nenit 403 par. 1 pikës 12, aktgjykimi mund të kundërshtohet mbi bazën e shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale nëse “dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm ose kundërtë në brendinë e tij ose kundërtë në arsyet e aktgjykimit..”.

e) Duke e pasur parasysh se dispozitivin është pjesë integrale e aktgjykimit ai duhet lexuar dhe interpretuar në lidhje me pjesët tjera të aktgjykimit e posaçërisht me arsyetimin.


f) Në bazë të parimit të përgjithshëm një akt duhet të interpretohet në atë mënyrë që të ketë kuptim dhe jo në atë mënyrë që nuk ka kuptim, dispozitivi dhe arsyetimi duhet lexuar së bashku (ligji e parasheh që ato duhet të jenë në përputhje me njëra tjetrën); vetëm nëse dispozitivi mbetet i pakuptueshëm ose nuk përputhet pasi të jetë lexuar në lidhje me arsyetimin, mund të shpallet i kundërligjshëm dhe aktgjykimi mund të anulohet në bazë të kësaj kundërtënie.

g) Ky përfundim bazohet gjithashtu në parimin e ekonomisë gjyqësore i cili duhet të zbatohet duke e pasur parasysh qëllimin e sistemit për zgjidhjen e kontesteve. Qëllimi është zgjidhja e çështjes dhe “të sigurohet një zgjidhje pozitive për kontestin”. Në vlerësimin e pretendimit të gabimit ligjor, duhet pasur parasysh nëse të gjitha elementet e aktgjykimit të kërkuara me ligj janë të pranishme në vendimin e kundërshtuar. Të anulohet dhe kthehet në rigjykim një aktgjykim i cili nuk përmban elementet apo informacionet të cilat mund të gjenden lehtësisht në arsyetimin.

3. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut është i qartë dhe i kuptueshëm; është e vërtetë që nuk përmban arsyetim ose i mungon arsyetimi lidhur me faktet vendimtare, mirëpo duhet nënvizuar se KPPK-ja përcakton që arsyet e vendimit duhet të përfshihen në arsyetim dhe jo në dispozitiv.

Arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë është shumë i saktë; të gjitha dëshmitë janë analizuar me kujdes dhe faktet janë vërtetuar shumë mirë (aktgjykimi i Gjykatës së Apelit bazohet në faktet e njëjta për të cilën është dhënë një cilësim tjetër). Asnjë shkelje substanciale lidhur me të drejtat e të pandehurit nuk mund të gjendet.


Unë nuk mund të pajtohem as me gjetjen se dispozitivi mund të shpallet i pavlefshëm pa e urdhëruar rigjykimin në bazë të nenit 424 par. 4 të KPPK-së. Kjo rregull (“Kur arsyeja e vetme për anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe kur e gjitha që kërkohet për vërtetimin e drejtë është një vlerësim tjetër i fakteve të vërtetuara dhe jo mbledhja e dëshmive të reja ose përsëritja e dëshmive të paraqitura më herët, gjykata e shkallës së dytë nuk do ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë, por do të veproj sipas nenit 426 të këtij Kodi”) i referohet pjesës së dytë të nenit 424 par. 1 (gykata e shkallës së dytë e anulon dhe e kthen lëndën në rigjykim vetëm “ nëse konsideron se një shqyrtim i ri gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë është i domosdoshëm për shkak të vërtetimit jo të plotë ose të gabuar të gjendjes faktike”), dhe jo në rast të anulimit për shkak se “ekziston një shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale” (neni 424 par. 1 pjesa e parë).



KEDNJ-së as nuk mund të ofroj bazë ligjore për një interpretim shfuqizues të nenit 424 par. 1. Në fakt, rigjykimi nuk paraqet shkelje të vetë nenit 6 të KEDNJ-së; madje edhe zbatimi i tij shpie domosdoshmërisht në shtyrjen e gjykimit. Në rast të shkeljes përkatëse të rregullave të procedurës, rigjykimi është një instrument për sigurimin dhe garantimin e të drejtës në mbrojtje). Gjykata duhet të jetë e vetëdijshme se një zbatim jashtëzakonisht formal i rregullave të procedurës paraqet shkelje të parimeve themelore të përmbajtura në nenin 6 të KEDNJ-së e cila në fund të fundit pengon zbatimin e drejtësisë.

Anëtarja e kolegjit
Maria Giuliana Cívini

Prishtinë, 22 shtator 2010



Gjykata Supreme e Kosovës
AP – Kž. Nr. 128/2010

Mendim pjesërisht mospajtues i Gjyqtarit Gerrit-Marc Sprenger në pajtim me Nenin 420 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Në lëndën e mësipërme kundër F **B** e akuzuar për veprën penale Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës në ankesën kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Pejës ka konstatuar vendimin mbi faktet e veprimtë përkatëse si edhe mbi fajësinë e të pandehurit.

Megjithatë, çështja e të qenit apo jo e dispozitivit në pajtim me kërkesat e Nenit 396 paragrafi 3 dhe 4 si edhe në Nenin 391 paragrafi 1 i KPPK që më vonë është ngritur nga Avokati Mbrojtës në ankesën e tij kundër Aktgjykimit të shkallës së parë, nuk është shtjelluar nga Kolegji me intensitetin dhe përmbajtjen siç është pasqyruar në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

Në ankesën e tij avokati mbrojtës në veçanti ka theksuar se sipas mendimit juridik të tij *dispozitivi...i aktgjykimit ka mungesë të përshkrimit të fakteve të vendit të ngjarjes të veprës penale nga e cila mund të gjinden veçoritë e veprës penale, mënyra dhe rrethanat tjera të kryerjes së veprës të cilat do të shpien në saktësinë e duhur të veprës penale (p. 2 i ankesës; versioni në gjuhën angleze).*

Në lidhje me çështjen përkatëse të ankesës, në arsyetim të Aktgjykimit tani shënohet si më poshtë:

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk është tërësisht në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale (p. 5 versioni në gjuhën angleze).


Pastaj adresimi është bërë në Nenin 396 paragrafi 3 dhe 4 dhe në Nenin 391 paragrafi 1 pika (1) dhe (2) të KPPK. Mbi këtë sfond, arsyetimi vazhdon me sa vijon:

Në këtë mënyrë, dispozitivi si pjesë mjaft thelbësore e aktgjykimit duhet të përmbajë jo vetëm kualifikimin ligjor të veprës por po ashtu edhe përshkrimin e përpiktë dhe të detajuar të gjitha fakteve dhe rrethanave të cilat janë baza për zbatim të dispozitave ligjore. Çdo lloj dykuptimësie apo kundërshtimi e bën dispozitivin të pakuptueshëm.

Në lëndën në fjalë, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk pasqyron në tërësi këto kërkesa ligjore. I akuzuari është shpallur fajtor

*“Për veprën penale Vrasje të M **B** , sipas Nenit 146 të KPPK të kryer në më 24 Maj 2007”.*

Në këtë dispozitiv është përmendur vetëm një numër i vogël i fakteve respektivisht vetëm emri i viktimës si edhe data dhe vendi i krimit. Kjo nuk është plotësisht e mjaftueshme. Përshkrimi i kërkuar faktik i veprës konkrete e kryer nga i akuzuari p.sh mungon mënyra me



privuar viktimën nga jeta. E njëjta bie për paramendimin e saj që është parakusht i nevojshëm për vrasje megjithëse nuk është përmendur aspak në dispozitiv.

Si rezultat, dispozitivi lënë të hapur mënyrën në të cilën viktimë është vrarë dhe në çfarë mënyrë i akuzuari saktësisht ka ekzekutuar atë vrasje.

Sipas Nenit 403 Paragrafi 1 pika 12 e KPPK është shkelje absolute substanciale e dispozitave të procedurës penale nëse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm. Sipas Nenit 424 Paragrafi 1 i KPPK kjo shkelje nuk lejon asnjë opsion tjetër për Gjykatën e Apelit përveçse anulimit të aktgjykimit dhe kthimin e lëndës për rigjykim...

Pastaj arsyetimi vazhdon duke thënë se:

Mund të argumentohet se e vetmja zgjidhje e paraparë me ligj – anulimi i aktgjykimit dhe rigjykimi vetëm për arsye formale – është shumë i ashpër dhe nevojitet interpretim korrigjues i ligjit me qëllim të shmangies së rigjykimeve, thjesht për arsye formale. Në rastin në fjalë, megjithatë, një paraqitje e përpiktë dhe e saktë e fakteve nuk mund të gjendet në arsyetimet e aktgjykimit po ashtu ... (p. 5-6 versioni në gjuhën angleze).

I nënshkruari nuk pajtohet me mendimin ligjor sikurse është përmendur në arsyetimin e sipërm të Aktgjykimit se dispozitivi nuk është në pajtimit me KPPK deri në masën që do të duhej të konsiderohej i paligjshëm.

I nënshkruari është i mendimit se dispozitivi i Aktgjykimit të shkallës së parë, së paku, i përmbush kërkesat minimale të KPPK dhe se është i kuptueshëm sepse nuk është i dykuptimshëm ose në kundërshtim me pjesën tjetër të Aktgjykimit të shkallës së parë.

Në veçanti, në Nenin 396 paragrafi 3 dhe 4 të KPPK thuhet si më poshtë:

(3) Dispozitivi duhet të përmbajë të dhënat e të akuzuarit (Neni 233 paragrafi 1 i Kodit aktual) dhe vendimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor për veprën sipas të cilës ai ose ajo është akuzuar ose sipas të cilës ai ose ajo është liruar nga akuzë e asaj vepre ose sipas të cilës akuzë është refuzuar.

(4) Po që se i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit duhet të përmbajë të dhënat e domosdoshme të specifikuar në Nenin 391 të Kodit aktual. ...

Neni 391 paragrafi 1 i KPPK – për aq sa është relevant në lëndën në fjalë – thotë me sa vijon:

Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1) Për cilën veprë shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;

2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrëveshjes së aktgjykimit;



Aktgjykimi përkatës i shkallës së parë në lidhje me çështjen që është në diskutim e sipër, thotë me sa vijon:

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË.....në lëndën penale kundër të akuzuarës F **B** ...(të dhënat personale)....e akuzuar, sipas Aktakuzës PP. Nr. 2002/2007, të datës 2/8/2007, për veprën penale në vijim:

Vrasje sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, sepse më 24 maj 2007, në ora 8:15, në **B**, në dhomën e mysafirëve të shtëpisë së saj, F **B** qëllimisht ka vrarë M **B**, bujk, 28 vjeçar, nga fshati i njëjtë.

Në veçanti, F **B** ka parë të ndjerin M **B** duke hyrë në shtëpinë e saj, ajo ka shkuar në dhomën e saj të gjumit dhe ka marrë pushkën e gjuetisë GA, me numër serik 146143, të kalibrit 12 mm, dhe ka shkuar në dhomën e mysafirëve dhe nga një distancë prej dy metrave ka qëlluar M **B** në gjoks dhe pasi që viktima ka rënë në dysheme e pandehura ka shtënë edhe dy herë në shpinën e tij, në këtë mënyrë duke i shkaktuar vdekje M **B** si rezultat i plagëve të marra nga të shtënat.

Krimi i dënueshëm nga pesë deri në njëzet vjet burgim.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik ... pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues ... shpall në publik dhe në prani të të akuzuarës këtë

AKTGJYKIM

F **B** është

FAJTORE

Për veprën penale Vrasje të M **B**, sipas nenit 146 të KPPK-së, të kryer në më 24 maj 2007.

Prandaj e akuzuara

DËNOHET

me 10 (dhjetë) vjet burgim.



1. I poshtë-nënshkruari është i mendimit së dispozitivi përkatës, edhe pse i mungon arsytimi më i detajuar mbi faktet vendimtare të cilat kërkohen sipas nenit 396, paragrafit 1 të KPPK-së që të përmenden plotësisht në pjesën e "arsyetimit" të cilitdo aktgjykim, në mënyrë të mjaftueshme i plotëson kushtet e nenit 396 paragrafëve 3 dhe 4 lidhur me nenin 391 paragrafin 1 të KPPK-së

Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë së paku përmend si fakte të krimit emrin e viktimës si dhe vendin dhe kohën e veprës. Në këtë kontekst vlen të përmendet se aktgjykimi përkatës si pjesë shtesë e hyrjes, i cili në këtë mënyrë nuk kërkohet me ligj, ofron detajet e veprës penale.

Në veçanti nuk mund të jetë *ratio legis* e dispozitës përkatëse të KPPK-së që të citohen faktet disa herë në dispozitiv dhe në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, vetëm për arsye të formalitetit ose të përfshihen pjesë të mëdha dhe të domosdoshme të arsytimit të aktgjykimit dhe gjithashtu në dispozitiv. Derisa ky dispozitiv është i qartë dhe i kuptueshëm, aktgjykimi duhet të konsiderohet si dokument unik i përbërë nga tri pjesë si hyrja, dispozitivi dhe arsytimi (neni 396 paragrafi 1 i KPPK-së). Pasi që dispozitivi është pjesë integrale (dhe më vendimtare) e aktgjykimit ai duhet lexuar dhe interpretuar në lidhje me të gjitha pjesët tjera të aktgjykimit.


Në këtë kontekst vlen të ceket se madje edhe vetë aktgjykimi i Gjykatës Supreme në arsytim përmend *se dëshmitë e paraqitura në shkallën e parë janë plotësisht të mjaftueshme për ta vërtetuar gjendjen faktike (faqe 9 e versionit në gjuhën angleze).*

2. Përveç kësaj, aktgjykimi i Gjykatës Supreme në arsytim, siç është diskutuar, krijon përshtypjes sikur të ishte kundërtë në brendinë e tij në kundërshtim të nenit 396 paragrafit 1 të KPPK-së. Përdorja e dispozitivit të aktgjykimit nuk e shpall pavlefshmërinë e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, arsytimi nënvizon se ... *sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së është shkelle absolute substanciale e dispozitave të procedurës penale nëse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm. Sipas nenit 424 paragrafi 1 i KPPK-së kjo shkelle nuk lejon opsione të tjera Gjykatës së Apelit përveç anulimit të aktgjykimit dhe kthimit të lëndës në rigjykim...*

Duke e marrë parasysh mundësinë që kjo pjesë e arsytimit mund të kuptohet si hyrje për interpretimin e ligjit sikur që është dhënë në vijim, duke thënë se .. *mund të vihet në pikëpyetje se e vetmja zgjidhje e paraparë me ligj – anulimi i aktgjykimit dhe kthimi i lëndës vetëm për shkak të arsyeve formale - është shumë i ashpër dhe ka nevojë për interpretime korrektuese të ligjit në mënyrë që t'i shmangemi rigjyqimeve vetëm për shkak të arsyeve formale...*, duhet nënvizuar se kjo – sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme - nuk përputhet në mënyrë eksplicite me këtë lëndë. Arsytimi deri më tani thotë se ...*në lëndën në fjalë, sidoqoftë, gjendja faktike e përpiktë dhe e saktë nuk mund të gjendet as në arsytimin e aktgjykimit. Në të kundërtën, mungesa e përshkrimit faktik në dispozitiv gjithashtu korrespondon me arsytimin e aktgjykimit, ...* . me aktgjykimin e Gjykatës Supreme nuk është nxjerrë asnjë konstatim përkitazi me këtë aspekt.

Megjithatë, duke pasur parasysh arsytimin, vendimi i vetëm i mundshëm për Gjykatën Supreme do të kishte qenë anulimi i Aktgjykimit të shkallës së parë dhe kthimi sërish i lëndës në rigjykim.

Në përgjithësi, i poshtë-nënshkruari konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është në mospërputhje lidhur me pasojat vendimtare të arsytimit të përshkruar më lart.



3. Sidoqoftë, sa i përket mendimit të poshtë-nënshkruarit, e vetmja zgjidhje e zbatueshme për t'u marrë me këtë çështje të dispozitivit është të kuptuarit e thellë të kushteve të Nenit 391, paragrafit 1, pikës (1) të KPPK-së. Rrjedhimisht, po qe se e lexojmë Aktgjykimin e shkallës së parë në mënyrë përmbledhëse, dhe jo si të paqartë por si aktgjykim të qëndrueshëm, atëherë i poshtë-nënshkruari nuk ka nevojë të deklarojë se dispozitivi i Aktgjykimit të shkallës së parë nuk është nxjerrë si duhet dhe se lënda duhet të kthehet sërish në rigjykim.

Gerrit-Marc Sprenger
Anëtar i kolegjit

Prishtinë, 27 shtator 2010

